



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 119 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30 / 08 / 2023

VENDIM

Nr. 26, date 30/08 /2023

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT TE PUNES PER PERCAKTIMIN E KRITEREVE TE LLOGARITJEVE
TE PRURJEVE PER SISTEMET E SHKARKIMIT TE DIGAVE SIPAS NUMRIT TE
POPULLSISE NE ZONEN URBAEN POSHTE DIGES QE NDOHET NE RREZIK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, "Per Miratimin e Rregullores per Sigurine e Digave dhe te Dambave" Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 30.08.2023 mori në shqyrtim çështjen e kriterëve kryesorë që duhet të merren në konsideratë gjatë llogaritjeve të prurjeve për sistemet e shkarkimit të digave të mëdha sipas numrit të njerezve që ndodhen në zonat urbane poshte digave dhe që ndodhen në rrezik nga prurjet e mëdha që shkarkohen nga këto sisteme.

Gjatë diskutimeve, antarët e KKDM theksuan problematikat që hasen gjatë projektimit të digave dhe rehabilitimit të tyre në lidhje me përcaktimin e kapaciteteve përcjellese të sistemeve të shkarkimit në funksion të prurjeve të mëdha që mund të vijne në pellgun ujembledhës të tyre si dhe rrezikshmeria prej këtyre prurjeve të njerezve që ndodhen në zonat urbane poshte digave. Me zhvillimin urban në shumë zona poshte digave është rritur edhe rreziku i përmbytjeve nga sistemet e shkarkimit të tyre gjatë plotave të mëdha. Në shumë diga përveç moshës së madhe të tyre dhe mungesës së një mirembajtjeje dhe monitorimi bashkëkohor janë vërejtur edhe probleme të mëdha teknike në të gjitha elementet e tyre të cilat kërkojnë një rivlerësim të gjendjes teknike të tyre dhe ripërmasim në funksion të kriterëve të reja dhe bashkëkohore për përcaktimin e prurjeve llogaritese të sistemeve të shkarkimit të këtyre digave si dhe marrjen e masave përmirësuese për zbutjen e përmbytjeve që mund të ndodhin gjatë këtyre plotave.

Aktualisht, vazhdon të jehet në fuqi disa norma të projektimit vetëm për digat e ujitjes të miratuara në vitin 1989 të cilat përcaktojnë disa koeficiente për sigurinë e prurjeve të shkarkimit në funksion të lartësive të digës dhe vëllimit të ujitjes në rezervuar dhe nuk marrin fare në konsideratë numrin e njerezve në rrezik që ndodhen në zonat urbane poshte këtyre digave. Duke u bazuar në rekomandimet e ICOLD si dhe në legjislacionin shqiptar të miratuar në vitin 2000, siguria e digave oerben teresine e masave organizative, teknike dhe financiare që garantojnë jo vetëm shfrytëzimin normal të digës por edhe mosçenimin e të tjerëve për të cilat diga mund të përbejë rrezik.

Antarët e KKDM ngritën shqetësimin e rishikimit të këtyre kriterëve për llogaritjen e prurjeve dhe përcaktimit të permasave të sistemeve të shkarkimit gjatë projektimit dhe rehabilitimit të tyre me synimin e rritjes së sigurisë së digës dhe zbutjen e problematikave në lidhje me zonat poshte digave të mëdha. Në diskutime u vu theksi tek domosdoshmeria e kriterëve të reja bashkëkohore duke u bazuar në eksperiencat e vendeve europiane dhe rekomandimet e reja të ICOLD të dhëna në Buletinet përkatëse si dhe në studimet e kryera vitetë fundit për rritjen e sigurisë në digat e kasakdave kryesore të vendit tne si dhe në digat e ujitjes.. Kriteret e reja duhet të synojnë jo vetëm zëvendësimin mekanik të Kushteve teknike në fuqi të projektimit, të cilat nuk janë rishikuar që prej 35 vitesh, por edhe rritjen e sigurisë së digave në funksion të ndryshimeve klimatike, zhvillimit urban në zonat poshte digave dhe marrjen e masave për mbrojtjen e njerezve në rrezik që ndodhen në këto zona urbane. Këto kriteret të reja teknike duhet të zbatohen në fushën e projektimit të digave, rehabilitimit dhe kontrollit të sigurisë së digave.

Bazuar në situatën aktuale, Antarët e KKDM ranë dakord për domosdoshmerinë e hartimit dhe miratimit të disa Kriterëve kryesorë në lidhje me llogaritjet e prurjeve përkatëse për sistemet e shkarkimit të digave të mëdha gjatë fazave të projektimit, rehabilitimit dhe shfrytëzimit të digave si dhe në sigurinë e digave ekzistuese në vendin tone sipas legjislacionit në fuqi nga institucionet përgjegjëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha,

VENDOSI:

- 1- Te ngrihet nje grup pune I perbere nga z. Arjan Jovani, Dhimiter Vogli, Andi Vila, Ermal Kacurri dhe Miriam Bogdani per te hartuar kriteret kryesore per llogaritjet e prurjeve ne sistemet e shkarkimit te digave te medha. Ky grup pune, brenda muajit Tetor 2023 do te hartoj nje raport ne lidhje me kushtet aktuale, kerkesat e reja per percaktimin e ketyre prurjeve si dhe do te jap propozimet dhe udhezimet perkatese ne lidhje me percaktimin e kriterëve per llogaritjen e prurjeve per sistemet e shkarkimit te digave te medha
- 2- Ti kërkoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Keshillit të Ministrave përgatitjen e Standartit Teknik Shtetëror për Percaktimin e prurjeve per llogaritjen e sistemeve te shkarkimit te digave ne funksion te numrit te njerezve ne rrezik qe ndodhen ne zonat urbane poshte digave duke u bazuar ne propozimet perkatese te grupit te punes dhe KKDM te shperhura permes vendimit te KKDM. Keto kriterëve duhet te perdoret per percaktimin e permasave dhe kapaciteteve percjellese të sistemeve te shkarkimit te tyre gjate fazes se projektimit te digave të reja dhe projekteve te rehabilitimit të digave te medha ekzistuese.
- 3- KKDM të mbështet këtë proces me ekspertë të fushës dhe përmes bashkëpunimit me institucione kërkimore-shkencore me eksperiencë në fushen e përgatitjes se standarteve teknike Ky proces dhe Standarti Teknik përkatës do të shqyrtohet dhe miratohet në KKDM si dhe institucionet shtetërore perkatese sipas legjislacionit në fuqi

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI
Arjan JOVANI

